

VENDIM
Nr. 933, datë 28.12.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA KURBIN, TË OBJEKTIT DHE TRUALLIT FUNKSIONAL TË PRONËS NR.1148, ME EMËRTIM “ISH-ESKU”, ME VENDNDODHJE NË LAÇ, KURBIN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR.467, DATË 18.7.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LAÇ, TË QARKUT TË LEZHËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Kurbin, të objektit dhe truallit funksional të pronës nr.1148, me emërtim “Ish-ESKU”, me vendndodhje në Laç, Kurbin, sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për akomodimin e administratës dhe për ushtrimin e funksioneve të veta administrative.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet prona nr.1148, me emërtim “Ish-ESKU”, me vendndodhje në Laç, Kurbin, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Kurbin, miratuar me vendimin nr.467, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”.

3. Bashkisë Kurbin i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Kurbin, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI Prona nr.1148, "Ish ESKU", Laç


MIRATOHET
Komandanti i Forcës Toksore
Ojeneral Brigade Nazmi **CAHANI**

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 2364,
Nr.Pasurise Vol. Fq.
Indeksi i Hartes K-34-88-(23-B)
Shkalla 1: 500
Adresa e pasurise Laç
Q/F Laç,
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes,Forca Toksore.

PUNOI
Topograf Nikoll TUSHI

DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. Ferdi **HYRAJ**

SPJEGUSE:
Sip. e Pronës = 4572.95 m²
Sip. nën objekt = 494.06 m²
Kufiri i Pronës



Shënimi:

Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës të FT nr.4797/3, datë 23.11.2016,
bazuar në dokumentat arkivor të marrë në arkivin e IGJIU dhe matjeve në terren,
hedhur mbi orofoton dhe kuadrin e bashkimit të HTR të dhënë nga ZQRPP,
Tiranë.